

Intervista për Gazetën Zëri
08.01.2016
Avdullah Hoti, Ministër i Financave

I. Buxheti – Pensionet

1. Si janë orientuar mjetet e buxhetit për vitin 2016?

Kuvendi ka aprovuar Buxhetin për vitin 2016 në linjë të plotë me objektivat e Qeverisë për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe stabilitet buxhetor dhe të harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Me buxhetin e vitit 2016 është rritur për 25% asistenca sociale për rreth 27 mijë familje që janë në këtë skemë. Është rritur për 34% buxheti për skemat e pensioneve të financuara nga shteti për rreth 40 mijë pensionistë kontribut dhënës. Është ndarë buxhet i mjaftueshëm për kompensimin e rreth 80 mijë të punësuar në sektorin publik për gjithë vitin, që është një kosto prej 40 milion euro. Me këtë buxhet vazhdohet mbështetja e bujqësisë në nivel siç ka qenë në vitin 2015. Kemi siguruar financim të pensioneve për veteranët dhe kategoritë e tjera të luftës, në vlerë prej 25 milionë euro. Kemi akomoduar plotësisht shpenzimet nëpër organizata buxhetore që derivojnë nga agjenda integruese e Kosovës, që është rreth 6 milion euro. Kemi rritur buxhetin për organet e drejtësisë, për prokurorinë me 13% dhe gjyqësinë me 6%. Kemi rritur buxhetin për Forcat e Sigurisë së Kosovës me 9% për modernizim dhe përmbushje të standardeve për transformimin e kësaj force në ushtri. Buxheti për shpenzime kapitale prej 463 milionë euro mundëson financimin e 39 shkollave dhe anekseve shkollore në mbarë vendin, ndërtimin e objekteve për universitetet e reja në Mitrovicë, Gjilan, Gjakovë dhe Pejë, ndërtimin 25 objekteve sportive, 4 qendra rinore, mbi 24 objekte të shëndetësisë primare, sekondare dhe terciare, 15 objekteve të kulturës dhe artit, mbi 116 rrugëve të ndryshme regjionale dhe lokale në tërë Kosovën, financimin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit dhe të projekteve të tjera kapitale që janë në vijim e sipër, mbi 30 projekte në ujëra dhe mbrojtje të mjedisit.

Ka edhe plot projekte tjera që financohen nga 10 marrëveshje për bashkëpunim financiar që kemi nënshkruar gjatë vitit 2015, në vlerë totale prej 143 milionë euro, prej të cilave 107 milionë janë kredi dhe 36 milionë euro grante.

2. Sa ka mbledhur këtë vit mjete Dogana e sa ATK-ja?

Të hyrat e mbledhura nga Doganat dhe Administrata Tatimore gjatë vitit 2015 kanë pasur një rritje shumë të madhe krahasuar me vitin 2014. Dogana ka mbledhur një shumë rekord prej 950 milion euro, që është 80 milion euro më shumë se në vitin 2014, apo 9.2% më shumë. Ndërkaq Administrata Tatimore ka mbledhur 332 milion euro, me një rritje prej rreth 30 milion euro, apo rreth 10% më shumë se vitin 2014.

Duke pasur parasysh se rritja ekonomike pritet të jetë rreth 3.8%, një performancë e tillë e të hyrave tatimore nënkupton se kemi pasur një përmirësim të dukshëm në funksionimin e të dy agjencive tatimore, por njëkohësisht kjo reflekton edhe ndikimin pozitiv të reformës fiskale në vend.

3. Si do të ndahen mjetet për rritjen e pensioneve?

Për vitin 2016, janë ndarë 23 mil euro shtesë për pensionistët kontribut dhënës, që e ka rritur buxhetin për këtë kategori nga 68 mil euro sa ka qenë më 2015 në 91 mil euro më 2016. Me ligj parashihet kategorizimi i këtyre pensionistëve sipas përvojës së punës dhe nivelit të arsimit që lidhet me atë përvojë pune dhe pastaj niveli i pensioneve do të përcaktohet bazuar në buxhetin e shtuar për sivjet. Kjo do të bëhet në konsultim me pensionistët dhe Ministri Abrashi është duke punuar shumë intensivisht në këtë drejtim.

4. Me buxhetin e vitit 2016 a janë ndarë mjete për shpronësimin e pronave për resorin e Brezovicës?

Buxheti i vitit 2016 ka një linjë të veçantë buxhetore, me një shumë të konsiderueshme për shpronësime, ku hyjnë shpronësime për projekte të ndryshme kapitale që ka shteti, përfshirë këtu edhe projektin e Brezovicës të cilin e konsiderojmë projekt të rëndësishëm së veçantë dhe si i tillë trajtohet nga të gjitha institucionet shtetërore.

II. MSA

5. Sa ndihmon MSA-ja në rritjen ekonomike të vendit?

MSA-ja e bënë tregun e Kosovës pjesë të tregut evropian në një periudhë afatmesme. Përmes masave që parashihen në këtë marrëveshje, Kosova përgatitet për integrim të plotë në BE në të ardhmen.

Të gjitha dokumentet tona strategjike, si Programi i Qeverisë, Korniza Afat-mesme e Shpenzimeve, Programi Kombëtar për Zhvillim, i kontribuojnë implementimit të reformave që janë pjesë e MSA-së. Prandaj, implementimi me sukses i prioritetëve tona strategjike, padyshim se do kontribuojnë në implementimin e MSA-së, dhe kjo do të bëjë që të kemi një rritje më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike.

6. Cilat janë të mirat tjera që sjell MSA për ekonomin e vendit?

Qeveria ka përgatitur Programin gjithëpërfshirës Kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asocim, që mbulon fusha të shumta dhe adresimin e sfidave të këtyre fushave, të tilla si sundimi i ligjit; reformat në administratën publike; kriteret ekonomike që përfshijnë fuqizimin e sektorit privat; përafrimin e legjislacionit me BE, etj., dhe çdo përmirësim në këto dhe fusha të tjera, padyshim se do të ndikojnë pozitivisht në ekonominë e vendit

III. Pakoja Fiskale

7. Nga 1 shtatori i vitit 2015 ka filluar aplikimi i reformave fiskale, cilat janë efektet e para që janë vërejtur në ekonominë e vendit?

Ligji i ri për TVSH i liron importet e lëndës së parë nga TVSH. Gjithashtu, lirohen makineritë, linjat e prodhimit dhe pajisjet e teknologjisë informative me rastin e importit. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e importit të këtyre mallrave që i referohen sferës së prodhimit dhe rrjedhimisht kanë impakt në absorbimin e fuqisë punëtore.

Prandaj, efektet e pakos fiskale janë të prekshme. Pas hyrjes në fuqi të pakos së re fiskale, 152 kompani kanë marrë autorizime për lirim nga TVSH-ja në import të lëndës së parë për prodhim, 163 kompani kanë shfrytëzuar mundësinë e importit pa TVSH të makinerisë prodhuese dhe teknologjisë informatike. Vlerësohet se mbi 30 mil euro janë investimet e ndërmarrjeve kosovare që kanë shfrytëzuar mundësinë e importit të pajisjeve pa TVSH. Nga këto investime, janë rreth 5 mil euro përfitime për këto kompani në firmë të mos pagesës së TVSH-së. Këto statistika, së bashku edhe me efektin e përshkallëzimi të TVSH-së kanë ndikuar dhe do të vazhdojnë të ndikojnë pozitivisht tek bizneset, në veçanti ato që merren me veprimtari prodhuese e përpunuese, si dhe tek qytetarët.

8. Çka po ndodh me operatorin e ri, pse nuk po futet ende ne treg?

Udhëzimi Administrativ i ri për Pajisjet Elektronike Fiskale ofron mundësi për paraqitjen e Operatorëve të ri në treg, ndërsa rimbursimi i një pjesëve të TVSH-së përmes dorëzimit të kuponëve fiskal është mirëpritur nga konsumatorët dhe ka ndikuar drejtpërdrejtë në uljen e informalitetit. Ka pasur interesim të operatorëve të rinj për tu futur në treg, të cilët janë në fazën e testimit dhe licencimit të pajisjeve fiskale që do të ofrojnë. Unë i inkurajojë ata dhe operatorët e tjerë potencial të shfrytëzojnë këtë mundësi pasi kërkesa për pajisje fiskale do të rritet gjatë vitit 2016, pasi ne do të koncentrohemi shumë në luftimin e informalitetit.

Shkaku kryesor i mos futjes në treg të operatorëve të ri deri në këto momente është, mos plotësimi i kërkesave për Pajisje Elektronike Fiskale që dalin nga Udhëzimi Administrativ nga bizneset e interesuara për të qenë Operator Ekonomik. Vlerësimin e plotësimin të kërkesave funksionale dhe teknike për çdo pajisje fiskale është laborator në Fakultetin Teknik, i cili është i autorizuar nga Administrata Tatimore. Deri sot kemi dy kompani që janë autorizuar nga Komisioni për Autorizim të Operatorëve Ekonomik që të kalojnë në Laborator për Certifikim të Pajisjes Elektronike Fiskale, mirëpo ende nuk kanë arritur të certifikojnë ndonjë Pajisje Elektronike Fiskale.

9. Përshkallëzimi i TVSH-se, a jeni duke e monitoruar a po zbatohet ? Çfarë masa do të merrni ndaj bizneseve të cilat respektojnë përshkallëzimin e TVSH vetëm gjatë muajit shtator, pastaj rriten çmimet e produkteve përsëri?

Ulja e normës së TVSH-së nga 16% në 8% për artikujt bazë dhe shërbimet komunale ka pasur efekt të drejtpërdrejtë në uljen e kostos për familjet. Legjislacioni tatimor, që është derivat i reformës fiskale, ka eliminuar dykuptimësitë dhe ka plotësuar vakumin ligjor për çështje të caktuara, krahasuar me atë paraprak. Pakoja e re është e thjeshtë dhe lehtë e kuptueshme nga tatimpaguesit. Sot, shporta e konsumit të një familjeje mesatare kushton mesatarisht rreth 25 euro më pak në muaj për shkak të përshkallëzimit të TVSH-së.

IV. Agjencia Qendrore e Prokurimit

10. Ka më shumë se një muaj që në zyrën tuaj janë disa kontrata të Agjencisë së Prokurimit Publik. A do t'i nënshkruani ato ? Pse një pjesë të tyre Agjencia Kundër Korrupsionit ka rekomanduar që të anulohen, por AQP-ja nuk e ka përfillur atë. A jeni në dijeni ?

Për herë të parë në këtë vit, kjo qeveri ka filluar me prokurimin e centralizuar, që do të thotë që për të njëjtin shërbim të kërkuar nga organizatat e ndryshme buxhetore, nuk do të ketë nevojë që gjithsecila organizatë të shpallë procedura tenderuese. Këtë e bënë Agjencia Qendrore e Prokurimit. Kjo ka dhënë një rezultat të mirë në kursimin e mjeteve buxhetore pasi që ka eliminuar çmimet e ndryshme për shërbimin e njëjtë. Një punë e tillë ka marrë nota pozitive dhe është vlerësuar nga të gjitha institucionet partnere të fushës. Sa i përket nënshkrimit të kontratave, unë vazhdimisht jam në kontakt me të gjitha institucionet relevante dhe kompetente që bëjnë vlerësimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së procedurave të ndjekura nga autoriteti kontraktues, dhe në bazë të konkludimeve të tyre edhe veprimet.

V. Raporti i Progresit

11. Raporti i Progresit shënon se nuk ka pasur progres në punësim, në politikat sociale dhe shëndetësore, 35,3 për qind apo më lartë papunësia vazhdon të jetë prej problemeve kryesore socio-ekonomike të vendit, si i përgjigjesh kësaj? Ky raport i KE-së hedh poshtë edhe pritjet e Qeverisë për rritje ekonomike prej 4 për qind, pasi aty thuhet se do të mundë të ketë 0,9 për qind, çka do të thotë kjo ?

Ne e marrim shumë seriozisht raportin e progresit dhe gjitha sfidat e identifikuar do të adresohen me përpikëri. Siç e dini në vitin 2014 rritja ekonomike ishte mjaft e ulët, me rreth 1.2%, ndërsa për vitin 2015, vlerësimet tona tregojnë se rritja e ekonomisë do të jetë rreth 3.8%. Nëse flasim për periudhën afat-mesme, rritja mesatare vjetore e ekonomisë, sipas skenarit bazë pritet të jetë mbi 4%. Natyrisht se kjo normë e rritjes nuk është ajo çfarë ne synojmë, por marrë parasysh ambientin ekonomik regjional dhe evropian, kjo normë megjithatë është mjaft premtuese. Një sinjal shumë i mirë i rritjes së besimit të investitorëve në ambientin investues në

Kosovë, është fakti se gjatë këtij viti kemi pasur një rritje substanciale të investimeve të huaja direkte. Në ndërkohë, siç e dini pjesë e planit tonë qeverisës janë edhe disa projekte shumë të mëdha investuese, siç është rasti me projektin e qendrës turistike të Brezovicës dhe projekti i termocentralit Kosova e Re, dhe me rastin e implementimit të këtyre dy projekteve, norma e rritjes ekonomike do të jetë shumë më e lart se ajo bazë. Dhe rrjedhimisht, ne presim që këto norma të rritjes të ndikojnë ndjeshëm në uljen e papunësisë dhe përmirësimin e kualitetit të jetës për qytetarët tanë.

12. Vërejtja tjetër është te politikat fiskale ad-hoc, ku potencohet se vetëm se kanë përkeqësuar zhvillimin e biznesit dhe konkurrencën, si do të veproni?

Për sa i përket politikave fiskale, siç e dini, reforma e bëra në këtë fushë, kanë qenë të parapara me Programin e Qeverisë, dhe të gjitha ndryshimet e bëra, janë koordinuar ngushtë me komunitetin e biznesit dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar.

VI. Luftimi i informalitetit

13. Çfarë plani të veprimit keni zgjedhur për të luftuar informalitetin?

Ne synojmë që përmes eliminimit të burokracisë në institucionet publike, thjeshtësimin të procedurave, përmirësimin të kualitetit të shërbimeve, komunikimit më të mirë me tatimpaguesit etj, të përmirësojmë qeverisjen dhe inkurajojmë formalizmin e bizneseve, duke trajtuar secilin biznes dhe qytetar në mënyrë të barabartë. Dhe më duhet të them se është bërë mjaft shumë në këtë drejtim, sidomos me reformat e bëra në ATK dhe Dogana. Ne kemi zgjedhur rrugën e bashkëpunimit dhe partneritetit me komunitetin e biznesit dhe qytetarët, ngase vetëm kështu jemi të bindur se do të arrijmë të ulim nivelin e evazionit fiskal. Rritja e të hyrave tatimore ndjeshëm mbi normën e rritjes ekonomike, është një prej treguesve të uljes së informalitetit. Po ashtu kemi rritur koordinimin e aktiviteteve të të gjitha institucioneve që mbulojnë këtë fushë, siç është rasti me ATK, Dogana, Njësia për Inteligjencës Financiare, Polica, BQK, etj. për tu siguruar se të gjitha këto institucione synojnë të njëjtën gjë.

14. Sa biznese kanë arritur të fiskalizohen prej kur ka filluar rimbursimi i kuponëve fiskal, a keni shifra konkrete?

Vetëm gjatë periudhës korrik-dhjetor 2015 janë fiskalizuar 1,368 biznese, kurse janë instaluar 2031 pajisje fiskale. Numri i përgjithshëm i bizneseve që janë fiskalizuar dhe numri i pajisjeve fiskale që janë instaluar që nga fillimi i projektit të arkave fiskale është 23,385 biznese të fiskalizuara dhe 30,360 pajisje fiskale të instaluar. Gjatë vitit 2016 ne do t'i shtojmë aktivitetet tona në këtë drejtim.

Me respekt,

Avdullah Hoti
Ministër i Financave